

SHF TIGO FAJNANS SHPKNJP Shkup në bazë të Dekretit me fuqi ligjore për aplikimin e Ligjit të Shoqatave financiare gjatë situatës së jashtëzakonshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 90 e datës 04.04.2020), më datë 09.04.2020 shpall këtë:

OFERTË PUBLIKE
Për ndryshimin e kushteve të kontraktuara të produkteve kreditore të
SHF TIGO FAJNANS SHPKNJP Shkup

Oferta i referohet të gjithë klientëve të SHF TIGO FAJNANS SHPKNJK Shkup që janë përdorues të kredive sipas kontratave të kredive që janë nënshkruar dhe paguar deri më 31 mars të vitit 2020.

Informacioni i detajuar i Ofertës:

1. Shtyrja e 70% të detyrimeve të anuiteteve mujore për muajin prill, maj dhe qershor 2020 (Grejs-periudha për 70% të detyrimeve të anuiteteve mujore për muajin prill, maj dhe qershor 2020)

- Në periudhën nga 1 prilli deri më 30 qershor të vitit 2020, përdoruesit e kredive sipas kontratave të kredive që janë nënshkruar deri më 31 mars të vitit 2020 mund t'i paguajnë detyrimet e anuiteteve mujore për muajt prill, maj dhe qershor 2020, të zvogëluara për 70% të shumës së rregullt të anuitetit mujor të përcaktuar nga Kontrata e Kredisë;

- Detyrimet në bazë të anuiteteve më pak të paguara në periudhën nga 1 prilli deri më 30 qershor të vitit 2020, shtyhen në përputhje me afatin e shtyrë të pagesës ose njëtrajtësisht shpërndahen në anuitetet mujore që do të maturojnë pas 30 qershorit të vitit 2020.

2. Plani i ri i Amortizimit të Shlyerjes

- SHF TIGO FAJNANS SHPKNJP Shkup do të përgatisë një plan të ri amortizimi të shlyerjes së kredisë me një shumë të zvogëluar të anuiteteve për 70% për periudhën nga 01.04.2020 deri më 30.06.2020 dhe për shlyerjen e detyrimeve në bazë të anuiteteve më pak të paguara (30% të anuiteteve mujore për muajin prill, maj dhe qershor 2020).

3. Vazhdimi i afatit të shlyerjes

- Periudha e shlyerjes së kredisë vazhdon për një periudhë prej 90 ditësh, llogaritur nga 30 qershori i vitit 2020:

4. Llogaritja e kamatave, kompensimeve dhe provizioneve

- Për periudhën nga 01.04.2020 deri më 30.06.2020, SHF TIGO FAJNANS SHPKNJP Shkup nuk do të llogarisë kompensimet, shpenzimet, provizionet dhe/ose kamatat ndëshkuese shtesë.

- Për kohëzgjatjen e periudhës së mbledhjes së shtyrë të borxhit, do të llogaritet kamata e kontraktuar sipas shkallës së kamatës së parashikuar në Kontratën e Kredisë. Mbledhja e kamatës së kontraktuar e periudhës së mbledhjes së shtyrë do të fillojë pas vendosjes së kredisë në shlyerje të rregullt.

5. Dispozitat tjera të kontraktuara

- Të gjitha dispozitat tjera të kontraktuara të kontratës ekzistuese të kredisë, që nuk janë përfshirë në këtë ofertë, mbeten të vlefshme për gjithë kohëzgjatjen e Kontratës.

6. Efekti juridik i Ofertës

- Oferta do të konsiderohet si e pranuar nëse në afat prej 10 ditësh nga shpallja e kësaj Oferte, respektivisht më së voni deri më 19.04.2020, përdoruesit e kredisë nuk e kanë refuzuar atë duke parashtruar një kërkesë/njoftim të veçantë deri tek SHF TIGO FAJNANS SHPKNJ Shkup.
- Të gjitha kushtet e kësaj Oferte bëhen dispozita të kontraktuara që janë pjesë përbërëse e Kontratave të Kredisë. Kushtet e ndryshuara të Kontratave të Kredive, si dhe të gjitha dokumentet dhe sigurimet e noterit (kontratat për marrëveshjet e hipotekës dhe kontratat tjera për çdo sigurim) ndaj përdoruesve të kredive prodhojnë efekt juridik pa nënshkruar kontrata të reja dhe/ose anekse në kontratat ekzistuese.

SHF TIGO FAJNANS SHPKNJ Shkup mban të drejtën që përdoruesve të cilët nuk e kanë pranuar Ofertën t'u ofrojë favore të tjera për shlyerjen e kredisë.

Të gjithë klientët që dëshirojnë të vazhdojnë shlyerjen e rregullt si deri më tani, është e nevojshme ta refuzojnë ofertën duke i lutur ata që këtë ta bëjnë më së voni deri më 19.04.2020, në të kundërtën do të konsiderohet se oferta është PRANUAR.

Njoftim dërgojnë ekskluzivisht klientët që REFUZOJNË Ofertën, dhe atë përmes NJËRËS nga mënyrat E DETYRUESHME të ofruara për njoftim që janë listuar në vazhdim:

- Njoftim përmes rrugës elektronike në adresën e e-mailit covid19@tigo.mk ose përmes [profileve të tyre të klientit](#).
- Njoftim me shkrim me postë ose duke e dërguar direkt në arkivin e Shoqatës në adresën në vijim: Tigo Fajnans Shpknpj Shkup, Bul. "Jane Sandanski" nr. 109 A, kati 3, 1000 Shkup, me shenjën "Refuzim i ofertës së shtyrjes".
- Plotësim i një formulari në të gjitha filialet e Tigo Fajnans.

Nëse klientët nuk kanë mundësi të dërgojnë informacion se nuk e pranojnë ofertën në mënyrat e lartpërmendura, do të jetë e nevojshme që në afatin e parashikuar të njoftimit të vizitojnë filialin më të afërt dhe të japin njoftim me shkrim për mospranimin e ofertës.

Klientët do të njoftojnë Shoqatën Financiare se NUK e pranojnë ofertën, në komunikim detyrimisht të shkruajnë të dhënat në vijim:

1. Emrin dhe mbiemrin;
2. Numrin e identifikimit;
3. Telefonin e kontaktit;
4. Numrin e Kontratës së Kredisë
5. NUK E PRANOJ Ofertën Publike të TIGO FAJNANS

Të gjitha njoftimet me shkrim që do të pranohen në arkivin e Shoqatës Financiare në adresën e sipërpërmendur ose që janë dërguar me postë me vulën postare në zarf në afat prej 10 ditësh derisa vlen Oferta, do të pranohen se kanë mbërritur në kohë në Shoqatën Financiare.